



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2044/Prot.

Tiranë, më 01.08.2025

VENDIM

Nr. 207, datë 25.07.2025

**“PËR CAKTIMIN E PËRKOHSHËM NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM VLORË”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar (në mungesë)
5. Arta MANDRO	Anëtar (në mungesë)
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar (në mungesë)
10. Erind MERKURI	Anëtar (në mungesë)
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen plenare të datës 25.07.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 2044 prot., datë 17.07.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoi relatorin z. Sokol Stojani, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë *(në vijim Këshilli)* është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Si rezultat i pezullimit nga detyra sipas vendimit respektiv Këshillit, të prokurorit Aurel Zarka, me funksion drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, kjo e fundit ka vijuar të drejtohet nga prokurori Arian Xhaferraj, i cili mbante pozicionin e zëvendës drejtuesit të kësaj zyre.
3. Caktimi i tij si zëvendës drejtues i kësaj zyre prokurorie është bërë me Urdhrin nr. 16 datë 31.10.2022.
4. Bazuar në nenin 44, pika 4, të Ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mandati i zëvendës drejtuesit është dy vjet. Për këtë arsye afati i zëvendës drejtuesit përfundoi më 31.10.2024.
5. Për plotësimin e vakancës së krijuar, me Vendimin nr. 70 datë 24.04.2025, “Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë”, Këshilli caktoi përkohësisht prokurorin Erjon Shqarri në pozicionin e drejtuesit të kësaj zyre prokurorie, për periudhën 01.05.2025 deri më 30.07.2025.
6. Duke qenë se në përfundim të këtij afat, ky pozicion mbetet sërish vakant, bëhet i domosdoshëm plotësimi i tij, me qëllim garantimin e funksionalitetit normal të kësaj zyre prokurorie.
7. Në këtë rast, Këshilli vlerëson të përdorë mekanizimin e caktimit të përkohshëm për plotësimin e kësaj vakance.
8. Vlen të theksohet se “*caktimi i përkohshëm*” si mekanizëm ligjor me qëllim plotësimin e vakancës eventuale, legjitimohet të zbatohet duke referuar si bazë ligjore:
 - i. Nenin 42, pika 2, të Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“... Pozicioni është përkohësisht i lirë kur magjistrati që ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, për të paktën 3 muaj, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion”;

- ii. Nenin 59, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të: caktimit në pozicione të tjera, arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji”;

- iii. Nenin 3, Rregullores “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, “Kriteret për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, ku përcaktohet se:

“Prokurori mund të caktohet përkohësisht në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin përmbush kërkesat dhe kriteret e parashikuara në ligj për këtë nivel apo pozicion, në të njëjtën prokurori ku ushtron funksionin ose në një prokurori tjetër”.

9. Për të garantuar qëndrueshmëri dhe stabilitet për atë që është e mundur në drejtimin e kësaj zyre, Këshilli vlerëson të caktojë sërish në këtë detyrë prokurorin Erjon Shqarri. Zoti Shqarri ka mbi 8 vite vjetërsi si magjistrat dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi.
10. Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, bazuar në ligj dhe në rregulloren e lartpërmendur, si dhe pasi bëri verifikimet përkatëse pranë zyrës së burimeve njerëzore, i propozoi Këshillit që ky prokuror të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë për një afat tre muaj, duke filluar nga data 31.07.2025 deri në datë 30.10.2025, pasi plotëson kushtet e përcaktuara në ligj dhe në Rregulloren përkatëse.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës, në nenin 59, pikat 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 184, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe nenin 3, të Vendimit nr. 64, datë 15.04.2019, “Për miratimin e Rregullores “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, e ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Caktimin e përkohshëm të prokurorit Erjon Shqarri në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë për një periudhë tre muaj, duke filluar nga data 31.07.2025 deri në datë 30.10.2025.
2. Për periudhën e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, prokurori Erjon Shqarri të paguhet me pagën e pozicionit ku është caktuar përkohësisht.

3. Të njoftohen me këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë dhe prokurori Erjon Shqarri.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 25.07.2025.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Erion Fejzulla

ZV/KRYETAR
Erind Germenji

ANËTAR
Moisi Duda